



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2019:109403

Datë: 24.05.2021

Numri i dokumentit: 01805028

C.nr.98/2019

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Burhan Berisha, si gjyqtar individual, me bashkëpunëtorin profesional Ismail Kuçi, duke vendosur në çështjen kontestimore juridiko-civile të paditësit Z.V nga Hani i Elezit, të cilin me autorizim e përfaqëson M. K.-B. avokate nga Kaçaniku, kundër të paditurës Kompania "...”GP, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson G.N avokat nga Prishtina, rr. "...” nr..., për çështjen kontestuese kompenzimi i dëmit, në seancën kryesore të mbajtur me date 29.03.2021, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, ndërsa më date 28.04.2021 bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit Z.V nga Hani i Elezit dhe DETYROHET e paditura Kompania "...”GP, me seli në Prishtinë që paditësit të i’ a paguaj shumën prej 3.246.33€ (tre mijë e dyqind katërdhjet e gjashtë euro e tridhjetë e tre cent), në emër të dëmit për shtëpinë e banimit P+1 të ndërtuar në Pk.nr.00052-2, Z.k. ....

Këtë shumë me kamatë prej 8% duke filluar prej datës 29.03.2021 (data e seancës kryesore), e deri në pagesën definitive.

II. DETYROHET e paditurat që paditësit t’ia paguaj shumën në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 934.00€, të cilat pagesa do të bëhen në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës, si në padi ashtu edhe në seancat e mbajtura gjyqësore, ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurës që të i’ a paguaj shumën prej 3.246.33€ në emër të dëmit, për dëmtimin e shtëpisë, pasi që kjo shtëpi prone e paditësit është dëmtuar gjatë punimeve të të paditurës në afërsi të kësaj shtëpie e me rastin e ndërtimit të autostradës Prishtinë-Hani i Elezit, prandaj përgjegjëse për dëmin e tillë është e paditura.

Paditësi këtë shumë e ka kërkuar me kamatë prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive.

E autorizuar edhe gjatë seancave gjyqësore, ka sqaruar se këtë dëm paditësi e ka pësuar me fajin e të paditurës. E paditura këtë dam e ka shkaktuar gjatë punimeve të paditurës me rastin e ndërtimit të autostradës Prishtinë Hani i Elezit.

E autorizuar ka theksuar se nga ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë dhe plotësimi i sajë-sqarimi në seancë gjyqësore, është vërtetuar pretendimi i palës paditëse lidhur me dëmet e pësuar dhe se ekspertiza është bërë konform udhëzimeve të dhëna nga ana e Gjykatës.

Prandaj e autorizuar duke i pasur për bazë këto fakte të konstatuara ka theksuar se baza e kërkesëpadisë është e bazuar në nenin 136 të LMD-së. Me këtë dispozitë është përcaktuar se dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëmë i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së sajë (fitim i humbur). Po ashtu ka theksuar se me nenin 169 par. 1 të LMD-së, është paraparë se personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e më parshme, e cila ka qenë para shkaktimit të dëmit.

Shpenzimet i ka kërkuar.

E paditura përmes të autorizuarit, si në përgjigje në padi ashtu edhe në seancat e mbajtura gjyqësore, kërkesëpadinë e paditësit e ka kontestuar dhe i ka propozuar gjykatës që të njejtën ta refuzoj si të pa bazuar për arsyet se nuk është vërtetuar as baza as lartësia e sajë.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurës ka theksuar se kërkesëpadia e palës **paditëse** nuk është vërtetuar sepse në mungesë të provave nuk është vërtetuar fakti se cila ka qenë gjendja e më parshme e pasurisë kontestuese, po ashtu nuk është vërtetuar saktë periudha se kur janë shkaktuar këto dëme, po ashtu nuk janë precizuar saktë shkaktarët e këtij dëmi pasi që kemi të bëjmë me vjetërsinë e objektit dhe si fakt ka mundur të kontriboj apo të shkaktoj dëmet, dhe se sipas ekspertizës nuk ka arritur të dëshmoj se cilat makineri saktësisht e kanë shkaktuar dëmin, gjithashtu ka theksuar se vlera e dëmit e përcaktuar është bërë ditën kur eksperti ka dalë në vendngjarje e prandaj nuk është i saktë, dhe kjo vlerë është përcaktuar në mënyrë paushallë.

Shpenzimet i ka kërkuar

Për të vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar në mënyrë të drejtë në këtë çështje kontestimor të kompenzimit të dëmit, gjykata bëri administrimin e këtyre provave të shkruara u lexuan: certifikata pronësore e datës ..., kërkesa e drejtuar të paditurit e datës 12.03.2019, procesverbali nga DBPZHR-Hani i Elezit i datës 19.11.2018, fotografit e shtëpisë së dëmtuar 9 copë, ekspertiza e ndërtimtarisë e datës 20.11.2020 e punuar nga eksperti S. B., pa pyetje ndërsa me vërejtje të cilat u elaboruan në fjalën përfundimtare të dorëzuar gjykatës me shkrim.

Pas vlerësimit me kujdes dhe profesionalizëm të secilës prove veq e veq dhe të gjithave bashkërisht, e në bazë të dispozitave të nenit 8 të LPK-së, si dhe bindjes së lirë të gjykatë, kjo gjykatë për këtë qështj kontestimore vërtetoi këtë gjendje faktike:

Paditësi Z.V ka të ndërtuar shtëpinë e banimit në ... në parcelën kad. me nr.00052-2 në Zonën Kadastrale ..., gjatë punimeve nga ana e Kompanisë "...”GP lidhur me ndërtimin e autostradës “...” (autostrada Prishtinë-Hani i Elezit), rrespektivisht në segmentin e fundit të saj, në afërsi të shtëpisë së paditësit Z.V, janë shkaktuar dëmtime në shtëpinë e paditësit siq është: Nga ana e jashtme, në fasadë të shtëpisë në të trija muret janë paraqitur qarje dhe plasaritje në drejtime të ndryshme, nga ana e brendshme e mureve dhe tavanit të shtëpisë në përdhese ka shumë plasaritje, në këndet e dhomave të fjetjes në shtëpi, në tërë gjatësinë ka qarje në të dyja muret, në dhomën e fjetjes muri është në drejtimin e pjerrtë në tërë gjatësinë e murit, në banjo pran dritares ka qarje vertikale të murit, qarje janë të paraqitura edhe në tavan dhe në traun nga beton-armeja, në pllakë masive nga betoni në dhomën e fjetjes, e vlera e dëmeve arrin shumë prej 3.246.33€, të cilat dëme janë shkaktuar nga veprimet (vibrimet nga makineritë e rënda) e të paditurës me rastin e kryerjes së punimeve në ndërtimin e autostradës “...” e për mbulimin e dëmeve të tilla është përgjegjëse e paditura. Konform nenit 136 të LMD-së.

Faktet jo kontestuese:

Se paditësi është pronar i shtëpisë së banimit e cila gjenden në Han të Elezit në parcelën kad. me nr.00052-2 në Zonën Kadastrale ..., këtë fakt gjykata e vërtetoi në bazë të certifikatës pronësore e datës..., dhe se po ashtu ky fakt nuk ishte kontestuese nga palët ndërgjyqëse, po ashtu fakti se ka dëmtime në shtëpinë e paditësit nuk ishte kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, madje i autorizuarit i të paditurës në seancën kryesore ka deklaruar se nuk e konteston faktin se mund të ketë dëmtime në shtëpinë e paditësit por kontestuese mbeten faktet tjera siq janë llojet e dëmeve dhe nga kush janë shkaktuar ato etj, për të cilat do të elaborohen më poshtë.

Faktet kontestuese:

Në mes të palëve ndërgjyqëse në procedure kontestimore kontestuese ishte fakti se dëmtimet e përshkruara si në gjendjen faktike, nuk ishin të shkaktuara nga ana e të paditurës, dhe lartësia e dëmeve të tilla, koha e shkaktimit të dëmeve të tilla, faktorët të cilët i kanë shkaktuar këto dëme dhe se Gjykata faktin se dëmtimet e shkaktuara në shtëpinë e banimit janë shkaktuar nga ana e të paditurës e vërtetoi në bazë të ekspertizës se ekspertit të ndërtimtarisë e datës 20.11.2020 në faqen 5 të ekspertizës me shkrim ku theksohet se “ të qaratë dhe plasaritjet janë të paraqitura gjatë ndërtimit të trupit të rrugës-autostradës Prishtinë-Hani i Elezit, sepse para fillimit të punimeve nuk ka pasur kurrfarë dëmi në shtëpi-deklaroi pronari”, këtyre konstatimeve dhe theksimeve përmes ekspertizës me shkrim dhe sqarimeve në seancën gjyqësore, gjykata ua dha besimin e plotë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Faktin se dëmet e shkaktuara apo të ndodhura përbëjnë lartësinë e caktuar monetare të aprovuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, gjykata e ka bazuar po ashtu nga ekspertiza me shkrim e ekspertit të ndërtimtarisë e datës. 20.11.2020 në faqen 6 ku është bërë përlllogaritja profesionale e dëmtimeve në përdhësë dhe bodrum të shtëpisë, është përcaktuar vlera e dëmeve, po ashtu është llogaritur zbritja e amortizimit të shtëpisë si dhe është llogaritur edhe ku në tërësi është bërë llogaritja e demit të shkaktuar që ka shumën prej 3.246.33€, këto konstatime të ekspertit madje kanë arritur të jenë të qëndrueshme edhe në sqarimet shitesë në mënyrë të drejtpërdrejtë të cilat i ka dhënë eksperti në seancën gjyqësore duke iu përgjigjur pyetjeve dhe dilemave të palëve në procedure dhe gjykatës, prandaj gjykata në rastin konkret një ekspertizë të tillë të punuar në formë të shkruar dhe të sqaruar në formë të drejtpërdrejtë e konsideron të besueshme dhe me fuqi të plotë provuese në raport me faktet e paraqitura gjatë këtij gjykimi dhe njëherit konsideron se konstatimet e ekspertit kanë qenë profesionale, Brenda fushveprimtarisë së tij profesionale dhe iu kanë përgjigjur kërkesave të palëve në procedure, prandaj dhe gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata pas analizimit të padisë, provave të bashkangjitura padisë dhe provave tjera të nxjerrura gjatë këtij procesi gjyqësor dhe pretendimeve të palës paditëse, kërkesëpadinë e paditësit e ka miratuar në të bazuar dhe e ka detyruar të paditurën që të i'a paguaj shumat si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi. Gjykata e ka detyruar të paditurën që ta paguaj këtë dëm sepse me veprimet e të paditurës paditësit i është shkaktuar ky dëm, me rastin e vendosjes, Gjykata pati parasyshë dispozitën e nenit 136 par.1 të LMD-së me të cilën dispozitë është paraparë se *“kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompenzoj përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*.

Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike e cila u vërtetua në mënyrë të plotë dhe të drejtë që rezultoi nga të gjitha provat e nxjerrura dhe të vlerësuar, gjykata vlerëson se janë eliminuar të gjitha faktet kontestuese për vendim marrje dhe kërkesëpadinë e paditësit e miratoi në tërësi si të bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, duke zbatuar edhe dispozitën e nenit 323të LPK-së.

Meqenëse të paditurat kanë rënë në vonesë me kompenzimin e dëmit, Gjykata me kërkesën e paditësit dhe në bazë të nen.382 të LMD-së, e detyroi të paditurën që paditësit në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën prej 8% duke filluar nga data 30.04.2019 (data nxjerrjes së këtij aktgjykimi), e deri në pagesën definitive.

Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse, e cila kërkoi nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj në tërësi si të bazuar, këtyre theksimeve gjykata u'a dha besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Sepse është fakt i ditur se me veprimet e të paditurës ka ardhur deri tek shkaktimi i dëmit. Këto fakte janë sqaruar në mënyrë detale në pikat e shënuara më lartë të arsyesimit dhe nga ekspertiza të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Gjykata i analizoi pretendimet e palës së paditur e cila i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar sepse nuk është vërtetuar me asnjë

provë se si ka qenë gjendja e kësaj paluajtshmërie para se e paditura ti filloj punimet, nuk është vërtetuar fakti se a ka pasur dëmtime dhe nga kush janë shkaktuar ato, po ashtu dëmet e pretenduara ka theksuar se nuk janë shkaktuar vetëm nga e paditura por edhe nga vjetërsia e objektit, gjithashtu nuk është vërtetuar se të kujt kanë qenë makineritë të cilat kanë shkaktuar vibrimet e që pretendohet se janë shkaktuar dëmet, dhe se fakti se objekti i paditësit nuk posedon leje të ndërtimit dëshmon se vlerësimet janë dhënë pa profesionalizëm nga ana e ekspertit dhe nuk ka prova mbështetëse me të cilat vërtetohet kërkesëpapia e paditësit, e këtyre theksimeve gjykata nuk ua dha besimit pasi që të njëjtat theksime nuk gjenin mbështetje me asnjë provë, për më tepër kontestimi i ekspertizës së ekspertit të ndërtimtarisë nga ana e të autorizuarit të paditurës nuk është i qëndrueshëm pasi që gjykata gjatë gjithë procedurës ua ka dhënë mundësinë palëve ndërgjyqëse që ti vërtetojnë pretendimet e tyre e në rast të vërtetimit të ndonjë fakti konkret ato ti vërtetojnë përmes propozimit të nxjerrjes së provave me ekspert të ndryshëm, mirëpo gjatë seancës përgatitore dhe atë kryesore nuk ka pasur propozime të tjera e ndërsa gjykata ka vepruar konform nenit 4, 5 dhe nenit 7 dhe po ashtu nenit 2 të LPK-së ku përcaktohet se “në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtrua nga palët ndërgjyqëse”, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata e detyroi të paditurin që paditësit të ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 934.00€, edhe atë shumën prej 104 € për përpilimin e padisë, shumën prej 540€ për 4 seanca gjyqësore, shumën prej 250 € për ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë dhe shumën prej 40 € në emër të taksës për padi (të parapara sipas udhëzimit administrativ nr.1/2017 të Këshillit Gjyqësorë), gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1 të LPK-së

Nga të gjitha arsyet e paraqitura dhe rezultatet e përgjithëshme të procedurës kontestimore, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ  
Dega në Kaçanik  
C.nr.98/2019 prej datës 29.03.2021

Gjyqtari  
Burhan BERISHA

UDHËZIME JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë të paraqes ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.